



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Bazuar në nenin 62.3 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenin 17.2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 17 paragrafi 2.3 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenin 64.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, bënë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Njoftohen përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile – OJQ-ve lokale që të bëjnë propozimet e anëtarëve të tyre për plotësimin e përbërjes së Komisionit që do të ngritet në Kuvendin e Komunës së Podujevës dhe atë;

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Në kuadër të Komisionit në fjalë do të përfshihet një anëtar i sektorit jo-qeveritar lokal.

Personat e nominuar për Komisionin e cekur, ndër të tjera, duhet t'i dorëzojnë; CV-të e tyre si dhe një letër interesim – rekomandim për pjesëmarrje në këto Komisione, ku prezantohen arsyet e nominimit.

Përzgjedhja e përfaqësuesve bëhet me votim në Kuvendin e Komunës.

Afati për aplikim është nga data **24.03.2026** deri më **30.03.2026**, brenda orarit zyrtar të punës, dhe të njëjtat bëhen përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Propozimet gjithashtu mund të dërgohen edhe përmes postës elektronike zyrtare, në emailin;
dpkgj.podujeva@rks-gov.net
ardiana.dibrani@rks-gov.net

Nr.Pro: 08-020/04-0016752/26
Datë 24.03.2026



Drejtoresha
Saranda Stublla